

URDHËR
Nr. 261, datë 26.4.2023

**PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM PËR NËNSHKRIMIN E
DOKUMENTEVE NË EMËR TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionim e administratës shtetërore”; si edhe të pikës 19, të nenit 17, të urdhrit nr. 348, datë 18.9.2015, të ministrit të Kulturës (Rregullore e Brendshme e Ministrisë së Kulturës),

URDHËROJ:

1. Drejtorin e Përgjithshëm të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, znj. Entela Çipa, që në mungesë dhe me porosi të kryejë nënshkrimin e korrespondencave të përditshme shkresore, që janë kompetencë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës.
2. Gjatë periudhës së zëvendësimit të shqyrtojë dhe të miratojë çdo akt që kalon nëpërmjet sistemit *e-Akte*, në emër dhe për llogari të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës.
3. Gjatë periudhës së zëvendësimit të miratojë dhe të nënshkruajë elektronisht në emër dhe për llogari të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, në sistemin SIFQ dhe AFMIS.
4. Periudha e zëvendësimit është e vlefshme për datat 2.5.2023–5.5.2023, si dhe 9.5.2023–12.5.2023.
5. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës për zbatimin e këtij urdhri, si edhe Zyra e Protokollit për komunikimin e tij.
6. Ky urdhër është i vlefshëm vetëm për periudhën e përmendur në pikën 4 të këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË KULTURËS
Zerina Bruci